

Albanais

NGA PELENAT ... NË UTURAK

Në rrugën e autonomisë



Sommaire

Parathënie	3
Të respektojme ritmin e tij	4
Vështroj fëmijën tim	6
Si të shoqëroj fëmijën tim ?	8
Mënyra për t'ju ndihmuar	9
Kalimi nga pelenat në uturak	13
Vështirësitë e etapave	14
Të gjithë së bashku	16
Hyrja në shkollë	17
E pastër gjatë gjumit	18
E vërtetë ose E gabuar	20

Sikur për ecjen dhe të folurit, fëmija juaj do të arrijë në ritmin e tij të zotrojtë nevojën e tij për të urinuar dhe të shkojë në tualet(banjo).

Kur të vijë koha për të shkuar (tu ulur) në uturak, ai do ta bëjë të ditur! Vështroni atë, ju do të kuptoni zhvillimin e tij.

Ju mund të ndjeni presion, gjykime, krahasime nga ata që ju rrethojnë por edhe nga kërkesat e shkollës që do të të mirëpresë fëmijën tuaj. Mbahuni ! Ju jeni të vendosur më mire sesa të tjerët për të njohur ritmin e tij dhe për ta shoqëruar atë.



Në këtë aventurë të re, fëmija juaj është aktori kryesor. Duke u treguar të butë dhe të durueshëm ju do t'i jepni atij mbështetjen që ai ka nevojë për të kaluar me vetbesim nga pelena në uturak.

• Të respektojmë ritmin e tij •

Fëmija bëhet « i pastër » kur zhvillimi i tij arrin një pjekuri të caktuar neurofiziolgjike dhe psikologjike.

Para moshës 20-24 muajsh, sfinkteri (muskul) i fshikëzës dhe anusit hapen automatiksht kur këto janë plotë. Fëmija nuk ka asnjë kontroll mbi të.



Rreth 2 vjeç, dalëngadalë, fëmija mund të fillojë të bëhet e vetëdijshme për atë që po ndodh me trupin e tij:

- Ai identifikon nevojën për të bërë urinën ose kakën
- Ai ndjen kakën të kalojë
- Ai gradualisht bëhet i aftë të mbyllë (të përmbahet) dhe hapë (shtyjë) muskujt e saj kur ai dot
- Ai zbulon që këto ndjenja i mbushur dhe i zbrazur kanë lidhje direkte me atë që ai nxjerr jashtë trupit të tij.

Fëmija, natyrisht kurioz, mund të jet i interesuar nga ajo që ai prodhon dhe të ketë sjellje që mund të duken të habitshme : të prekë kakën e tij, të luaj me uturakun.....



Fëmija juaj është i vetmi “zot” i procesit.

Paralelisht, duke u rritur (pjekur) në kokën e tij fëmija fillon të shfaq interes për të bërë urinen dhe kakën.

Dalngadal, ai kërkon të veprojë si të rriturit : të shkojë tek uturaku, të mbajë brekë/kilota....

Edhe nëse fizikisht fëmija juaj është gati të ndahet nga pelena, ai vendos vetë për momentin kur ai nuk ka më nevojë ti mbajë ato.

Tash e tutje, vendimi për ta bërë apo jo, i takon plotësisht atij dhe ai kënaqet me ushtrimin e kësaj aftësie të re!

Tregoni atij interesin tuaj, inkurajoni atë dhe besoni atij.

Është e rëndësishme që ai të ndiejë që ky përvetësim i ri i takon atij. Nëse ndihet i privuar nga kjo, ai mund të rezistojë totalisht ose të nënshtrohet vetëm për të kënaqur të rriturit që e rrethojnë.

Nuk duket e interesuar? Mos hezitoni. Respektoni progresin e tij.

Thelbësore për zhvillimin e tij është që ai të jetë krenar të rritet në trupin dhe kokën e tij.

Për fëmijët që kanë nevoja të veçanta, hapat shkojnë në të njëjtin drejtim : të shoqërojnë fëmijën duke respektuar ritmin e saj. Megjithatë, në funksion të çrregullimeve, procesi mund të jetë më i gjatë dhe përvetësimi më me vonesë. Për disa fëmijë, ky përvetësim mund të mos bëhet.

Për të tjerët, ky do të bëhet ndryshe. Këto situata në çdo rast do të shoqërohen nga një profesionist i kujdesit shëndetësor.

Vështroj fëmijën tim

Çdo fëmijë zhvillohet në ritmin e vet dhe në mënyra të ndryshme.

Të jeni të vëmendshëm ndaj zhvillimit të tij.

Sjellje të ndryshme mund t' ju tregojnë se fëmija juaj po rritet në kokën e tij dhe po fillon të zotërojë trupin e tij.



Ai tregon se pelena e tij është e lagur



Ai ju imiton

Ai nuk do më pelena



Pelena e tij mbetet e thatë më gjatë

Ai përpiqet të zhvishet dhe të vishet vetë



Ai ngjit shkallët



Ai ulet



Ai fillon të shprehë nevojat dhe dëshirat e veta



Ai kupton udhëzimet e thjeshta

Ai bëhet kurioze kur ju shkoni në tualet

Kombinimi i disa prej këtyre shenjave mund t'ju tregojë që fëmija juaj po fillon këtë fazë të re të autonomisë së tij.

• Si të shoqëroj fëmijën tim ? •

Një qëndrim pozitiv dhe mbështetës.

Çdo fëmijë dhe çdo familje janë të ndryshme. Nuk ka «mënyrë të drejtë» për këtë.

Merrni kohë për të menduar dhe të bini dakord midis prindërish mbi mënyrën se si ju do t'a mbështesni dhe shoqëroni atë. Mos e vini veten nën presion, kështu ju do të shmangni për të rransmetuar atë, edhe pa dashje, tek fëmija juaj. Jepini atij kohë për tu pjekur në lehtësi e pa stres.

Dakordësia midis të rriturve është një vlerë për këtë fazë që kjo të kalojë nënjë mënyrë të qetë.



• Mënyra për t'ju ndihmuar •

Të familjarizohet butësisht



Në funksion të asaj që i pëlqen fëmijës t'aj dhe asaj që ju keni zakon të bëni me të, ju mund t'i lexoni ndonjë histori apo tregim*. Kjo do ta ndihmojë atë të kuptojë fazat e përvetësimit duke krijuar momente bashkëpunimi mes jush.

Veshje të përshtatshme

Në fillim, parashikoni veshje të lehta për tu veshur dhe hequr. Privilegjoni pantallona ose funde të buta pa rrip dhe kopsa, bluze në vend të paliçetave, kilota/brekë, këpucë me ngjitës...Ju gjithashtu mundeni të planifikoni pelena-kilota



* Ekzistojnë shumë libra për fëmijë. Kërkoni këshilla në bibliotekën më të afërt.

Uturak apo reduktues tualeti?

Zgjidhni ju. Përse nuk bashkoheni me femijën tuaj për zgjedhjen dhe blerjen e materialit që ajo do të përdorë ?

Prioritet duhet t'i jepet rehatisë dhe stabilitetit të tij: ai duhet të jetë në gjendje të ulet dhe të qëndrojë në mënyrë të pavarur. Por gjithashtu, të ndihet rehat dhe i sigurtë gjë që do të mundësojë një relaksim të mirë të muskujve të perineumit



Instalimi i fëmijës në uturak është gjithashtu i rëndësishëm. Për t'i mundësuar që të shtyjë mirë, pozicioni ideal është ulur, gjunjët të paktën në lartësinë e ijeve, bërrylat mbi gjunjë. Për të miratuar këtë pozicion, ai ka nevojë të mbështetet mirë këmbët në tokë (përdorimi i uturakut) ose mbi një shkallë (përdorimi i tualetit). Merrni kohën e duhur për të shoqëruar atë në tualet për të verifikuar nëse ai adopton një pozicion të mirë.

Vendosni uturakun në një vend të arritshëm dhe të mirëpritur dhe lini fëmijën tuaj të mësohet me atë me ritmin e tij. Uturak apo tualet, mendoni për ruajtjen e intimitetit të tij.

Ju ndjek në tualet

Nëse ai tregon interes dhe nëse ju jeni rehat me këtë mënyrë të të bërit, lejoni që ai t'ju shoqërojë kur ju shkoni në tualet. Kështu ai do të ketë rastin të shohë për çfarë shërben kjo, si bëhet...



Përdorimi i hapësirës së tualetit

Me ndihmën tuaj, fëmija do të familjarizohet me përdorimin e tualeteve : të zbrazë uturakun, të përdorë letrën higjienike, të lajë banjon, ...Për sigurinë e tij, mësojeni të lërë derën hapur (të mos mbyllet) kur ai është në tualet.



Për disa fëmijë, të shohë kakën « të ikë » mund të jetë e frikshme. Shpesh prania mbështetëse e të rriturve, respektimi i kohës së nevojshme për fëmijën për të kuptuar se çfarë po ndodh dhe ritualet e vogla (psh : t'i thojë mirëupafshim kakës së vet, të lajë banjon,...) do të bëjnë që fëmija të mos ketë më frikë.

Një higjenë të mirë që në fillim

Tualetet janë vende që kanë shumë mikrobe. Nuk është kurrë herët për të mësuar gjestet e duhura higjenike. Mbas kalimit të tij në uturak, mësoni fëmijën tuaj të fshihet me letër higjenike pastaj të lajë duart me sapun.



Facoletat e lagura nuk këshillohen nga pikëpamja shëndetësore (rrezik alergjie dhe irritime të mundshme) dhe mjedisi (jo të riciklueshme, pengojnë funksionimin e mirë të kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujrave kur ato hidhen në tualete).

Për shkak të përdorimit pa shpëlarje, ato lënë të ndenjurat e fëmijës të lagur, gjë që favorizon paraqitjen e irritimeve dhe futjen e lëndëve përbërëse të facoletës (konservues, parfume...) në organizmin e fëmijës.



Kalimi nga pelena në uturak

Fëmija juaj ju thotë « çiqi » kur e bën në pelenat e saj? Ai ju kërkon të shkojë tek uturaku? Sjellja e tij tregon nevojën e tij për të shkuar në tualet ? Përfintoni nga kjo për ti propozuar atij të ulet mbi uturak.

Herët e para munden et të jenë thjesht përpjekje pa bërë gjë brenda. Deri ditën kur do të ketë diçka !

Falenderoni atë, pa e ekzagjeruar, duke theksuar që ai po rritet dhe që ai mund të jetë krenar për këtë.

Dalëngadalë, në funksion të ritmit që ju keni vëzhguar, ju mund ta ftoni atë për të shkuar tek uturaku në momente të ndryshme të ditës. Koha e ndenjes mbi të nuk duhet të zgjasë më shumë se disa minuta. Nëse kjo nuk funksionon, mos insistoni, nuk është momenti i duhur.

Pas një kohe, fëmija juaj ndoshta do t'ju tregojë që ai nuk e do më pelenën. Atëhere propozoini atij ta zëvendësojë atë me brekë të vogla.



Vështirësi të etapave

Koha për të arritur kontrollin e sphincters (muskulit) ndryshon nga një fëmijë në tjetrin. Ashtu si një fëmijë që bie kur mëson të ecë, fëmija juaj mund të hasë situata që favorizojnë «aksidente».

Të njohësh vështirësitë e tij pa e qortuar por duke i shpjeguar se kjo mund të ndodhë, do ta inkurajojë dhe qetësojë atë.

Fëmija, I preqëndruar në lojën e tij e mban shumë gjatë urinën dhe përfundon duke bërë atë në rrobat e tij.



Gara, pishina, shëtitje...

Gara, pishina, shëtitje.... Ndodh që tualetet nuk arrihen dhe fëmija, sidomos në fillim të përvetësimit, nuk mund të përmbahet gjithmonë. Shpjegoni atij që WC-të nuk do të jenë të disponueshme gjatë një kohe periudhë kohe dhe propozoni atij të shkojë në tualet para se të niseni. Eventualisht dhe nëse ai është dakord, ju mund t'i propozoni atij që të mbajë një pelenë-brekë. Nëse ju ia shpjegoni mirë përse, ky përdorim i përpiktë i pelenës nuk do të provokojë kthim prapa.

Gjatë rrugës së pushimeve ose udhëtimeve të gjata, parashikoni « pauzë-urinimi »



Nëse keni vend, përse të mos merrni me vete uturakun në bagazhin tuaj? Ai do të jetë i mirëpritur gjatë qëndrimit tuaj (në hotel, shtëpi pushimi, kampe, ...) dhe fëmija juaj do të vlerësojë mundësinë e përdorimit të objektit të tij të njohur.

Kur ju arrini në një mjedis të ri, tregoini fëmijës tuaj ku ndodhen tualetet, letrat higjienike dhe lavamani. Ai do të ndihet më i sigurt dhe më i qetë për të vajtur atje në rast nevoje.

Disa ngjarje (transferimi, ndarja e prindërve, zia, hyrja në shkollë ...) mund të shqetësojnë fëmijën dhe të shpjegojnë kthime të vogla mbrapa, shpesh kalimtare.

Nëse ju konstatoni akoma shqetësime rreth moshës 4 vjeçare, konsultohuni me një profesionist të kujdesit shëndetësor.

Fëmija që thotë « jo » sistematikisht kur ju i propozoni atij që të shkojë tek uturaku mund të jetë në fazën e kundërshtimit. Gjatë kësaj periudhe, ai ka nevojë të afirmohet dhe do të reagojë fort nëse ndjen presionin nga të niturit. Duke respektuar ritmin e tij dhe duke pritur kërkesën e tij, ju do të shmangni përshkallëzimin dhe konfrontimin.



Në fillim, merrni me vete një ndërrim komplet (brekë, çorape, pantallona).

Të gjithë së bashku

Kur fëmija kërkon të shkojë tek uturaku ose ai fillon të shkojë vet atje, diskutoni për këtë me personat që kujdesen zakonisht për të. Infermierë fëmijësh, edukator, mësues, gjyshër... Që të gjithë të jenë koherente, të vëmendshëm dhe dashamirës ndaj fëmijës dhe të veprojnë në të njëjtën mënyrë.



Hyrja në shkollë

Disa shkolla duket se kërkojnë që fëmija të jetë i pastër për të hyrë në kopshtin e fëmijëve. Megjithatë, për këtë, nuk ka asnjë detyrim ligjor. Për më tepër, kjo kërkesë nuk përputhet gjithmonë me ritmin e zhvillimit të secilit fëmijë.

Në kohën e regjistrimit, mos hezitoni të bëni pyetje rreth asaj se çfarë bën shkolla për të ndihmuar fëmijët në këtë evolucion.

Në ditën e parë të shkollës, tregoni fëmijës suaj tualetin, letrën higjienike, lavamanin por edhe njerëzit që mund ta shoqërojnë ose kë duhet të pyes.

Pastaj, shqyrtoni zhvillimin e fëmijës tuaj me mësuesin/mësuesen e tij dhe me personelin e pritjes jashtëshkollore, pa e bërë këtë aspekt subjektin kryesor të shkëmbimeve tuaja.

Aksidente mund të ndodhin: mos u shqetësoni. Kjo është një kohë kur fëmija duhet të menaxhojë shumë ndryshime në jetën e tij.




Në fillim, vendosni në çantën e tij një ndërrim komplet (brekë, çorape, pantallona).

E pastër gjatë gjumit

Nëse për ndonjë, një mungesë e pelenës gjatë ditës shoqërohet gjithashtu me një mungesë të saj gjatë gjumit, për të tjerët kjo do të zjasë më shumë

Fëmija që fle duhet të ndiejë sinjalin që i dërgon fshikëza e tij e plotë dhe të zgjohet. Ai duhet pastaj të jetë mjaft zgjuar për të urdhëruar muskujt e tij të mbeten të mbyllura. Pastaj, të ngrihet e të shkojë tek uturaku ose në tualet.

Për fat të mirë, gjatë muajve, kapaciteti i fshikëzës rritet. Për këtë arsye ai merr gjithnjë e më shumë kohë për tu mbushur gjë që lejon të «mbahet» një natë e tërë në të thatë.



Si të bëni ?

Përvetësimi i pastërtisë gjatë dremitjes mund ta përgatisë fëmijën për përvetësimin e saj gjatë natës.

Pelena është e thatë kur mbaron dremitja? Pas disa herësh, ju mund të pyesni fëmijën nëse ai ka nevojë apo jo për pelenën e tij për të fjetur. Ai do t'ju thotë ose do t'ju tregojë nëse ai është i gatshëm të menaxhojë dremitjen e tij pa pelenë!

Ju mund të vazhdoni me të njëjtën mënyrë për natën: nëse ai zgjohet disa mëngjese me pelenën e tij të thatë, ai ndoshta është i gatshëm të mos e veshë më atë.



Propozoini atij të bëjë urinën përpara se të shkojë të flejë.

Vendosni uturakun pranë shtratit të tij dhe sigurohuni që ai mund të lëvizë në mënyrë të sigurtë (dritë, shkallë ...).

Ashtu si gjatë ditës, mund të ndodhin aksidente. Të jini të durueshëm. Për të mbrojtur çarçafin e poshtme dhe dyshekun, mendoni të përdorni një mbrojtës

Deri 6 vjeç, fëmija mund të lagë pelenën apo shtratit e saj gjatë natës.
Mos u shqetësoni, nuk ka asgjë anormale.

Hormonet gjithashtu mund të luajnë një rol në vonimin e përvetësimit të pastërtisë së natës.

Një kujdes mjekësor në lidhje me urinimin e pavullnetshëm (urinimi në shtrat) shpesh fillon rreth moshës 7 vjeçare.

E vërtetë / E gabuar



Në 18 muaj shumica e fëmijëve janë të pastër

E GABUAR

Para 20-24 muaj, muskujt hapen dhe mbyllen pa vetëdije. Më pas, fëmija fillon gradualisht të bëhet i vetëdijshëm për atë që po ndodh në trupin e tij. Me të arritur këtë nivel pjekurie, ai gradualisht mund të fillojë përvetësimin e pastërtisë.



Nuk ka sezon më të mirë për të filluar përvetësimin

E VËRTETË

Çdo fëmijë arrin maturinë e nevojshme për të qënë i pastër me ritmin e tij. Për disa, kjo periudhë bie në dimër, për të tjerët në verë. Nuk ka asnjë moment më të favorshëm se një tjetër. Vetëm faza e zhvillimit të fëmijës dhe shenjat që tregojnë se ai duket i gatshëm duhet të merren parasysh.



Fëmija im bën urinën në uturak por kakën në brek. Duket sikur përvetësimi i pastërtisë behet me 2 shpejtësi!

E VËRTETË

Kontrolli i fshikëzës dhe i zorrëve nuk bëhet gjithmonë në të njëjtën kohë dhe kjo është normale. Jini të vetëdijshëm se sa gjëra mëson fëmija juaj në të njëjtën kohë. Është e pamundur që ai të arrijë të menaxhojë gjitha në të njëjtën kohë. Për më tepër, edhe nëse ai bën tashmë urinën në uturak, ndoshta ai nuk është ende gati t'u thotë lamtumirë përgjithmonë pelenave të tij. Disa fëmijë, gjithashtu, ndihen më të sigurt të bëjnë kakën fillimisht në pelenën e tyre para se ata të jenë gati ta lëshojnë atë në uturak.

Gjithçka ka të bëjë me pjekurinë fizike dhe psikologjike. Nuk shërben asgjë ta qortojmë atë. Është poshtëruese për të dhe kundërproduktive sepse për mos ju zemëruar, ai mund të përpiqet të frenojë veten, një zakon i marrë shpejt që mund ta çojë atë drejt kapsllëkut.

Kapsllëku është një problem që nuk haset tek fëmijët e vegjël

E GABUAR

Përkundrazi, është shumë e zakonshme tek fëmijët, madje edhe në mesin e të rinjve. Ndonjëherë kjo mund të kalojë pa u vënë re për një kohë dhe të shkaktojë dhembje dhe paretat. Për ta parandaluar këtë, përveç dietës së ekuilibruar dhe aktivitetit të rregullt fizik, është e mundur të veprohet në nivele të tjera, si: pershembull :

- Mësojini atij pozicionin e duhur në uturak që favorizon një shytje dhe zbrazje efikase të zorrëve (shih f.10),
- Shpjegoni atij rëndësinë e marrjes së kohës për të bërë kakën.
- Në fillim të përvetësimit, nuk është e këshillueshme të lëmë fëmijën më shumë se disa minuta në uturak. Përkundrazi, kur përdorimi i tij ka përfitime, ftoni atë të marrë kohë për t'u çlodhur në tualet për të favorizuar lëshimin e sfinkterit dhe ekspulsimin. Leximi i një historie, duke luajtur një lojë të vogël ... mund të ndihmojë në krijimin e këtij momenti qetësie.
- Flisni pozitivisht për kakën, shpjegoni atij: nuk është e ndyrë, është diçka e natyrshme dhe e nevojshme. Dhe është normale që kaka bie erë të keq pas një udhëtimi të gjatë në zorrë. Tregojini atij: në shoqërinë tonë, rregulli është se nuk luhet me të, është e tillë për të gjithë. Mos tregojini ndonjë ngurrim me qëndrimin tuaj ose me fjalët që përdorni, kjo mund të çojë fëmijën tuaj që të mendojë se ajo që del nga trupi i tij është e ndyrë. Dhe të nxisni atë që të pengojë këtë prodhim që të tjerët e konsiderojnë të neveritshme duke e mbajtur aq sa është e mundur.

Djali im duhet të bëjë urinën në këmbë

E GABUAR

Fëmija duhet të ndjehet rehat, i sigurt mbi uturak. Në mënyrë të natyrshme, djali i vogël bën urinën dhe kakën në uturak. Të bësh urinën në këmbë kërkon disa shkathtësi dhe disa trajnime që ai do të ketë mundësinë për t'i zhvilluar gradualisht më pas. Çdo gjë në kohën e tij.



Profesionistët në mjedisin pritës e dinë më mirë se si ta shoqërojnë një fëmijë në përvetësimin e pastërtisë

E GABUAR

Profesionistët janë atje për t'ju ndihmuar, por jo për ta bërë atë në vendin tuaj! Roli juaj si prind është i rëndësishëm sepse fëmija juaj kthehet së pari nga ju për t'i shpjeguar atij atë që ai nuk e kupton, ëai ndjek shembullin e juaj .Për më tepër, ju e njihni atë më mirë se kushdo tjetër dhe kjo njohuri është e domosdoshme për ta shoqëruar atë më së miri në procesin e tij të përvetësimit. Megjithatë, kur në shtëpi, ju do të vëzhgoni sjellje të caktuara të fëmijës tuaj që tregojnë se ai fillon të interesohet për uturakun, bisedoni me profesionistët e mjedisit pritës dhe mos hezitoni të pyesni ata për këshilla. Përvoja e tyre dhe njohuritë e tyre për fëmijën tuaj do të jenë të çmueshme. Lidhja midis shtëpisë dhe çerdhës do të bëhet atëherë krejt e natyrshme për hir të vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë.



Përgëzimi i sukseseve të fëmijës suaj është i nevojshëm, t' i japësh atij një shpërblim nuk është i nevojshëm

E VËRTETË

Të falenderosh fëmijën tuaj kur ai kalon një etap të këtij procesi (të kërkojë të shkojë tek uturaku, të ulet mbi uturak, të bëjë urinën në të...) rrit motivimin dhe vetëbesimin e tij. Arritja për të bërë si një i madh është në vetvete një shpërblim sidomos nëse ju i njihni përpjekjet e tij dhe e inkurajoni atë në një mënyrë të natyrshme dhe të dashur: *urime ... bravo! Ti rritesh! Ti mund të jesh krenar për veten...*

Është e rëndësishme të mos bëni «shumë» dhe të përqëndroheni «shumë» në rezultatet e përpjekjeve të tij. Një sistem shpërblimi, për shembull, nuk do të ndihmojë fëmijën të rritet. Ai mund ta integrojë atë që për të vazhduar të meritojë kënaqësinë tuaj është e detyruar të ketë sukses, sa herë, që ju i kërkon të bëjë atë. Në këtë kontekst, fëmija mund të ndiejë se nuk është më i vetmi «zot» i procesit, frikësohet nga zhgënjimi juaj ... Një presion më shumë për të!



Fëmija im më ndjek në tualet. Duket se kjo mund ta ndihmojë

E VËRTETË

Fëmijët e vegjël mësojnë shumë duke imituar shembullin që u është dhënë atyre nga më të mdhënjet. Dëshira për të vëzhguar prindërit, vëllain apo motrën në tualet është një hap i natyrshëm në procesin e të mësuarit rreth pastërtisë. Për fëmijën tuaj, kjo është një mundësi për t'u njohur me përdorimin e uturakut dhe për të vëzhguar konkretisht se si ju zbatoni atë që ju i kërkonti atij. Mos u turpëroni, ai sigurisht nuk sheh asgjë tronditëse. Megjithatë, nëse nuk jeni rehat, thjesht shpjegoni atij refuzimin tuaj dhe më pas lexoni një libër për ta bërë atë të kuptojë se çfarë po ndodh në tualet



Ka dallime midis vajzave dhe djemve

E GABUAR

Ka kryesisht ndryshime në ritmin e zhvillimit ndërmjet fëmijëve



Përdorimi i një gjuhë të kujdeseshme, mbështe fëmijën

E VËRTETË

Për sa i përket «pastërtisë», nuk është e rallë që, pas vetëdije, ne përdorim mënyra të të folurit që mund të lëndojnë dhe dëmtojnë vetëvlerësimi e fëmijës suaj (shembull: ti ke lagur prapë shtratin tënd, ti je i pistë, kaka jote bie erë të keqe ...).

Zgjidhni shprehjet : « Bravo, është e mrekullueshme, e ke arritur, e ke kuptuar, mund të jesh krenar për veten, do të kesh sukses, nuk është e lehtë por ti do t'ia arrish, kam besim te ti, si ka rëndësi, ne kemi gjithë kohën e nevojshme ... ».



Mos hezitoni të kontaktoni ekipin e konsultimeve të ONE-së një profesionist të kujdesit shëndetësor për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve tuaja.

NGA PELENAT ... NË UTURAK



© shutterstock_JGA



Chaussée de Charleroi 95 - 1060 Bruxelles
Tél. : +32 (0)2 542 12 11 / Fax : +32 (0)2 542 12 51
info@one.be - ONE.be

Redaktor përgjegjës: Benoît PARMENTIER
Chaussée de Charleroi 95 - 1060 Bruxelles
N° d'édition : D/2016/74.80/27
Traduction: SETIS Wallonie



Avec le soutien de la Fédération Wallonie-Bruxelles
et de la Loterie Nationale

